



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.882/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Ferki Xhaferi kryesues, Rustem Thaqi dhe Faton Ademi anëtar, duke vendosur përkitazi me apelin e kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal në Komunën e Prizrenit, Dafina Bllaca nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Komunën e Prizrenit, paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 të datës 03.11.2021 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021 për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur më datë 06.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. Pranohet si i bazuar apeli Anr.882/2021, i paraqitur nga kandidatja për anëtare të Kuvendit Komunal në Komunën e Prizrenit, Dafina Bllaca nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal.

II. Urdhërohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) që të rinumëroj vetëm fletëvotimet për kandidaten për anëtare të Kuvendit Komunal të Prizrenit, Dafina Bllaca nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Komunën e Prizrenit, në Vendvotimet: 2001A/03R, 2001A/02R, 2015/04R, 2015A/05D dhe 2015A/01R.

III. Rezultati i cili del pas rinumërimit të fletëvotimeve në kutitë e Vendvotimeve si në pikën -II- të këtij dispozitivi, të përfshihen në rezultatin përfundimtar.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar apelin me datën 04.11.2021 nga anëtarja për Kuvend Komunal në Komunën e Prizrenit, Dafina Bllaca nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Komunën e Prizrenit, me të cilën pretendon se në vendvotimet 2001A/03R, 2001A/02R, 2015/04R, 2015A/05D dhe 2015A/01R ka shpërputhje të madhe në mes të votuesve në raport me rezultatet e publikuara. Në vazhdim të apelit pretendon se ekziston dyshimi i bazuar se ka të bëjë me keqpërdorim apo pakujdesi gjatë numrimit të votave, sepse thekson se e kanë votuar familjarët dhe të afërmit e saj dhe votat e tyre nuk janë numëruar ose nuk janë proceduar fare.

Andaj përmes apelit ka kërkuar që të bëhet rinumërimi në Vendvotimet 2001A/03R, 2001A/02R, 2015/04R, 2015A/05D dhe 2015A/01R

Si provë ka bashkangjitur deklarat e votuesve dhe kopjet dokumentit identifikues (letërnjoftimi) të cilët kanë deklaruar se e kanë votuar në këto vendvotime.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, vlerësimit të provave të bashkangjitura dhe sipas hetimit të kryer nga vet PZAP, në ankesë në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i bazuar

Paneli vlerësoi se pretendimet ankimore janë të bazuara, pasi që, pas shqyrtimit të provave dhe shkresave të lëndës, si dhe nga hetimi i bërë në materialet zgjedhore, ka konstatuar se ka mungesë të votave të kandidatës për anëtare të Kuvendit Komunal të Komunës së Prizrenit, Dafina Bllaca nga radhët e Subjektit Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), siç rezultoi edhe nga provat e ofruara si dëshmi nga vetë pala ankuuese, andaj mbi këtë bazë dhe në mbështetje të nenit 117.4 të LZP-së, PZAP-i urdhëron KQZ-në, që të bëhet rinumërimi i të gjitha fletëvotimeve për kandidaten Dafina Bllaca, nga Subjekti Politik PDK, dega në Komunën e Prizrenit, në Vendvotimet: 2001A/03R, 2001A/02R, 2015/04R, 2015A/05D dhe 2015A/01R, dhe rezultati i dalur nga ky rinumërim të përfshihet në rezultatin përfundimtar të Zgjedhjeve Lokale, të vitit 2021.

Paneli, vlerëson se ky rinumërim e bën procesin e numërimit të fletëvotimeve dhe shpalljen e rezultateve të saktë në kuptim të nenit 101 paragrafi 1 i LZP-së, me të cilin përcaktohet se: *“Procedura e numërimit të fletëvotimeve qeverisen nga objektivat e mëposhtme: saktësia, transparencja, efikasiteti, mundësia për rinumërim dhe përsëritja e zgjedhjeve dhe mbrojtja e fshehtësisë së votës”*. Nga kjo rezultoi se mos procedimi i fletëvotimeve sipas dispozitës së lartë cituar, përveç cenimit të saktësisë, transparencës dhe kredibilitetit, po ashtu cenon integritetin e procesit zgjedhor dhe se pa evitim të kësaj parregullsie, përmes rinumërimit, ky integritet dhe kredibilitet do të vihet në pikëpyetje. Për çka mbi bazën e të lartë cekurave Paneli, ka vendosur si në pikën -I- dhe -II- të dispozitivit të këtij vendimi.

Andaj PZAP nga këto arsye, dhe në mbështetje të nenit 117.4 urdhëron që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve për vendvotimin e lartcekur.

Prandaj më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura dhe bazuar në nenin 115.1, dhe nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze* po ashtu lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr. 882/2021 më datën 06.11.2021.

Kryesues i Panelit
Ferki Xhaferi



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.